



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 16/2018 regjistër (JR)
Datë 12.09.2018

Nr. 11 i vendimit
Datë 22.11.2018

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesues
Ina Rama	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare

mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 22.11.2018, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare Elka Ermenkova, me sekretare gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Tom Ndreca, gjyqtar në Gjykatën e Lartë, i përfaqësuar nga Avokate Mine Progonati, me prokurë nr. 877 kol. me nr. 4198 rep., datë 12.07. 2018.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr.39, datë 17.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (në vijim referuar Aneksi i Kushtetutës).

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar ligji nr. 84/2016).

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim referuar ligji nr. 44/2015).

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim referuar ligji nr. 49/2012).

TRUPI GJYKUES I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) me vendimin nr. 39, datë 17.07.2018, ka vendosur:

“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Tom Ndreca, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë Tiranë.”

Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit D e DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Vendimi nr. 39, datë 17.07.2018, është marrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Tom Ndreca, bazuar në vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe kontrollit të figurës pasi nga Komisioni është konkluduar se kanë rezultuar të vërtetuara se:

Për kontrollin e pasurisë:

- i. deklarime të pasakta dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 (neni 33, pika 5/a, e ligjit);*
- ii. mungesë e burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë në shumën prej 1.393.336 lekësh. (neni 33, pika 5/b e ligjit);*
- iii. fshehje pasurie, autoveturë me targa {***} (neni 33, pika 5/c e ligjit);*
- iv. deklarime të pasakta, mosdeklarime dhe mospërputhje deklarimesh, në deklaratat periodike, në kundërshtim me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe*

kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;

- v. *Deklarim të rremë lidhur me çmimin e blerjes së garazhit (neni 33, pika 5/ç e ligjit);*
- vi. *Deklarim i rremë, i bashkëshortes dhe fëmijëve në autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, në pjesën “nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruara në emrin tim” (neni 33, pika 5, germa “ç” e ligjit).*

Për kontrollin e figurës:

- i. *Ka pasaktësi në plotësimin e formularit për pastërtinë e figurës.*

II. Shkaqet e ankimit

Kundër vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Tom Ndreca, i cili ka kërkuar që të ndryshohet vendimi nr. 39, datë 17.07.2018, i Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë duke paraqitur këto shkaqe:

A. Shkaqe që lidhen me çështje të natyrës procedurale dhe procesit të rregullt

1. *Subjekti pretendon se nga Komisioni nuk është njoftuar për ndryshimin e përbërjes së trupit gjykues dhe se i është shkelur e drejta procedurale për t’u njohur me këtë ndryshim, veprim të cilin e konsideron shkelje të rëndë procedurale që ka passjellë shkelje të të drejtave të subjektit në procesin e rivlerësimit.*
2. *Lidhur me zhvillimin e procesit të rivlerësimit pranë Komisionit, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i marrë nga Komisioni bazuar në shqyrtimin e vetëm 2 (dy) kriterëve, atij të kontrollit të pasurisë dhe të figurës, e bën procesin e rivlerësimit të parregullt si në referim si të ligjit nr. 84/2016, ashtu edhe në kuptim edhe të nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.*

B. Shkaqe ankimi për konstatim të gabuar të gjendjes faktike

3. *Subjekti pretendon se qëndrimi i mbajtur nga Komisioni për deklarin e rremë, lidhur me pagimin e çmimit për blerjen e pasurisë së paluajtshme të llojit “garazh” në rrugën “{***}” Tiranë, është i padrejtë dhe nuk pasqyron të vërtetën, e cila mbetet ajo që ka parashtruar subjekti gjatë gjithë procesit të rivlerësimit.*
4. *Subjekti kundërshton qëndrimin e mbajtur nga Komisioni në lidhje me pasaktësitë në deklaratat periodike dhe mospërputhjet e konstatuara mes deklarimeve në këto deklarata e atyre në deklaratën “vetting” si një qëndrim që e ka penalizuar atë padrejtësisht duke parashtruar se në thelb këto pasaktësi apo mospërputhje vijnë për shkak të neglizhencës dhe/apo pakujdesisë, por në asnjë rast nuk kanë synuar të fshehin apo deklarojnë në mënyrë të pasaktë pasurinë. Në këtë kontestim subjekti ka renditur konkluzionet e Komisionit në lidhje me:*
 - i. *mënyrën e likuidimit të pasurisë me nr. {***};*
 - ii. *arsyetimin se subjekti ka kërkuar të përfitojë kredi të butë në mënyrë abuzive;*

- iii. pasaktësi në deklarin e vlerës së huas së dhënë nga vëllezërit dhe motrat;
 - iv. pasaktësi në drejtim të vlerës së përfutuar nga shtija e banesës në Rrëshen;
 - v. mungesën e deklarin të likuiditetit prej 1.502.097 lekësh në vitin 2016;
 - vi. mosdeklarim të llogarive bankare në deklaratat periodike të personave të lidhur.
5. Subjekti ka kontestuar analizën financiare të kryer nga Komisioni, e cila ka konkluduar se ai ka mungesë të burimeve financiare në shumën prej 1.393.336 lekësh. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti përdor edhe të dhënat dhe konkluzionet e arritura prej një akti ekspertimi kontabël, të hartuar nga studio “{***}” për llogari të subjektit. Ai pretendon se Komisioni ka përdorur të dhëna jo të sakta për të kryer këtë analizë dhe ka kontestuar disa prej tyre.
 6. Subjekti ka kontestuar konkluzionin e Komisionit se mosdeklarimi i një automjeti tip Mercedes Benz prej tij përbën fshehje të pasurisë, duke pretenduar se konkluzioni mbështet në të dhëna të pavërteta.
 7. Subjekti ka kontestuar konkluzionin e Komisionit për sa i përket deklarin në autorizimin për kontrollin e pasurisë së personave të lidhur, të cilët shprehen se “nuk disponojnë pasuri veçmas”, nuk duhen konsideruar si shkak shkarkimi.

C. Shkaqe të ankimit që lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit material

8. Subjekti ka kontestuar konkluzionin e Komisionit për sa i përket deklarin në autorizimin për kontrollin e pasurisë së personave të lidhur, të cilët shprehen se “nuk disponojnë pasuri veçmas”, nuk duhen konsideruar si shkak shkarkimi.
9. Subjekti pretendon se Komisioni në hetimin e kryer nuk mori asnjë provë të re dhe nuk ka dhënë asnjë argument për të shpjeguar arsyen që vendimmarrja e tij lidhur me vlerësimin e pasurisë është ndryshe nga ajo e ILDKPKI-së.
10. Subjekti pretendon se fakti që Komisioni nuk provoi se subjekti ka deklaruar pasuri më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, e bën të gabuar qëndrimin e Komisionit për shkarkimin e tij mbështetur në kriterin e vlerësimit të pasurisë.
11. Subjekti ka kontestuar konkluzionin e Komisionit lidhur me kontrollin e figurës sipas së cilit subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës në shtojcën 3 të ligjit nr. 84/2016 (bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016) duke mos deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës, kontakte me të afërm të cilët janë persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (në vijim referuar ligji nr. 10192, datë 03.12.2003).

III. Rrethanat e çështjes

1. Nga shqyrtimi i akteve që janë administruar gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, z. Tom Ndreca, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor

Mirditë në periudhën dhjetor 1991 - prill 1994. Më pas ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë në periudhën prill 1994 - 26.04.2013. Nga muaji prill 2013 e në vazhdim, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë Tiranë. Ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi duke qenë se është anëtar i Gjykatës së Lartë, në zbatim të nenit 4, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

2. Për subjektin e rivlerësimit, z. Tom Ndreca, Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së tij dhe në zbatim të nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën me nr. 638/27, datë 17.11.2017, sipas të cilit për subjektin ka konstatuar:

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Për këtë qëllim, ky institucion ka dërguar pranë Komisionit 2 (dy) raporte lidhur me rezultatet e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit. Në raportin e dytë të hartuar prej këtij institucioni pas informimit me të dhëna të dala nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, DSIK në përmbushje të procedurave ligjore sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca për vijimin e ushtrimit të detyrës.

4. Komisioni ka përfunduar hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Tom Ndreca, për dy komponentë: komponentin e vlerësimit të pasurisë dhe të figurës. Me vendimin nr. 39, datë 17.07.2018, Komisioni ka konkluduar se:

4.1 Lidhur me kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit Tom Ndreca kanë rezultuar të provuara se ka:

- ✓ deklarime të pasakta dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003 (neni 33, pika 5/a, e ligjit);
- ✓ mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë në shumën prej 1.393.336 lekësh (neni 33 pika 5/b e ligjit);
- ✓ fshehje pasurie, autoveturë me targa {***} (neni 33, pika 5/c e ligjit);
- ✓ deklarime të pasakta, mosdeklarime dhe mospërputhje deklarimesh në deklaratat periodike, në kundërshtim me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë", i ndryshuar;
- ✓ deklarim të rremë lidhur me çmimin e blerjes së garazhit (neni 33 pika 5/ç e ligjit);

- ✓ *deklarim i rremë, i bashkëshortes dhe fëmijëve në autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, në pjesën “nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim” (neni 33, pika 5, germa “ç” e ligjit).*

4.2 Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni ka konkluduar se për subjektin e rivlerësimit Tom Ndreca, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, kanë rezultuar pasaktësi gjatë plotësimit të formularit për pastërtinë e figurës, duke e konsideruar këtë pasaktësi si një deklaram të pamjaftueshëm dhe shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

Në vlerësim dhe shqyrtim të procedurës administrative të ndjekur gjatë procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale që ka paraqitur subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, arsyeton si më poshtë:

1. Lidhur me shkakun e paraqitur në ankim nga subjekti ku pretendon se nuk është njoftuar për ndryshimin e përbërjes së trupit gjykues gjatë procedurës administrative, duke iu shkelur e drejta për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues, veprim të cilin e konsideron shkelje të rëndë procedurale që ka pasqjellë shkelje të të drejtave të subjektit në procesin e rivlerësimit, Kolegji e gjen si një pretendim të pambështetur në situatën faktike që konstatohet nga shqyrtimi i akteve, si dhe në dispozitat ligjore që rregullojnë të drejtën e palëve në proces për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues.
2. Nga shqyrtimi i akteve të administruara në proces rezulton se në datën 30.11.2017 është hedhur shorti për përcaktimin e trupit gjykues që do shqyrtonte procesin e rivlerësimit për subjektin Tom Ndreca, i cili përbëhej nga Firdes Shuli (relatore), Alma Faskaj (kryesuese) dhe Roland Alia (anëtar). Me vendimin nr. 29, datë 23.05.2018, të Komisionit është vendosur që për arsye objektive të zëvendësohet komisionerja Alma Faskaj me komisioneren Brunilda Bekteshin në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues. Subjekti i rivlerësimit rezulton që të jetë njohur nga Komisioni në datën 06.06.2018, me përbërjen e trupit gjykues dhe ka konfirmuar në të njëjtën ditë se nuk ka konflikt interesi me asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues.
Gjithashtu rezulton se edhe në seancën dëgjimore publike, të zhvilluar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më datë 13.07.2018, subjektit i është deklaruar publikisht përbërja e trupit gjykues. Nga verifikimi i akteve të administruara dhe procesverbalit të seancës gjyqësore, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë ngritur ndonjë pretendim apo kundërshti për përbërjen e trupit gjykues apo për faktin e ndryshimit të saj pa u vënë ai në dijeni, as gjatë fazës së hetimit paraprak dhe as në seancën dëgjimore. Në analizë të këtij pretendimi, Kolegji konstaton se subjekti në ankim nuk ngre ndonjë pretendim që lidhet me ekzistencën e ndonjë shkakut papajtueshmërie apo konflikti interesi të ndonjë prej anëtarëve të trupit gjykues, që do të kishte cenuar parimin e paanësisë dhe objektivitetit dhe për pasojë të kishte shkelur normat e procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ.
3. Përpos fakteve që u përmendën më lart, në analizë të dispozitave ligjore që rregullojnë të drejtat e palëve në proces për kundërshtimin e përbërjes së trupit gjykues, konstatohet se asnjë dispozitë e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por as e ligjit nr. 44/2015, nuk parashikon një mënyrë apo afat të posaçëm për

komunikimin te subjekti i rivlerësimit të përbërjes së trupit gjykues, ndërkohë që neni 27 i ligjit nr. 84/2016 garanton të drejtat e palëve për një proces të paanshëm, për sa kohë që parashikon mundësinë e përjashtimit të një anëtari të trupit gjykues kur ekzistojnë shkaqe papajtueshmërie, sipas nenit 30 të ligjit nr. 44/2015 dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Në këtë kuptim, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, fakti që Komisioni ia ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit trupin gjykues fillimisht në përfundim të procedurës hetimore dhe përsëri në seancën dëgjimore, përbën përmbushjen e detyrimit ligjor për t’i garantuar subjektit të drejtën për të ngritur çdo pretendim në raport me shkeljen e parimit të paanësisë në procesin e rivlerësimit, pretendime që subjekti nuk i ka ngritur në asnjë moment të procesit, por nuk i ngre as sot në ankimin e tij. Për këto shkaqe, trupi gjykues çmon se e drejta e subjektit për t’u njohur me trupin gjykues i është garantuar atij plotësisht dhe se nuk gjenden shkelje të natyrës procedurale të kryera nga Komisioni në këtë drejtim.

4. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i marrë nga Komisioni bazuar në shqyrtimin e vetëm 2(dy) komponentëve, atij të kontrollit të pasurisë dhe të figurës, e bën procesin e rivlerësimit të parregullt në referim si të ligjit nr.84/2016 ashtu edhe në kuptim edhe të nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kolegji gjen me vend të nënvizojë një qëndrim tashmë të mbajtur edhe në çështje të tjera të ngjashme të shqyrtuara prej tij, i cili mbetet i njëjtë në vlerësimin edhe të trupit gjykues që gjykon këtë çështje dhe mbështet qëndrimin e mbajtur prej Komisionit për këtë aspekt duke e konsideruar si të rregullt procesin e rivlerësimit të mbështetur edhe në më pak se tre komponentë.
5. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues çmon se dispozita që legjitimon dhe normon këtë vendimmarrje të Komisionit, është neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve ose në vlerësimin tërësor të procedurave.*

Në kuptim të kësaj dispozite, vendimi për procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit mund të merret bazuar në një ose disa prej kritereve, që do të thotë se nëse në një moment të caktuar të zhvillimit të procedurës hetimore administrative nga ana e Komisionit, ky i fundit arrin në përfundimin se ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit bazuar në rezultatet e arritura nga procedura hetimore për vlerësimin edhe vetëm të një kriteri, ligji e lejon Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit për atë kriter dhe të marrë një vendim për shkarkimin e subjektit, pa qenë e nevojshme që procedura administrative të vazhdojë më tej me verifikimin e kritereve të tjera, për sa kohë një vendim është bërë tashmë i arritshëm.

Kjo vendimmarrje e Komisionit është e mundur të ndodhë vetëm në ato raste kur Komisioni çmon se gjendemi para kushteve të parashikuara nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016 dhe provat kanë një nivel të tillë të provueshmërisë që të bëjnë të besosh se jemi para prezumimit ligjor të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Pavarësisht vendimit që mund të merret në këtë fazë, për të mbyllur hetimin administrativ mbështetur vetëm mbi një ose dy kritere, Komisioni në funksion të zhvillimit të një procesi të drejtë e në respektim të së drejtës së subjektit për t’u dëgjuar e mbrojtur, mundet ta revokojë këtë vendimmarrje pas kryerjes së seancës dëgjimore e analizës së pretendimeve të subjektit krahas provave të administruara nga hetimi dhe të vazhdojë procedurën hetimore administrative edhe për komponentët e tjerë. Ndërkohë që parashikimi i nenit 59 të ligjit

nr. 84/2016 kërkon që, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet detyrimisht të vlerësojë të tria kriteret në mënyrë kumulative. Në nenin 59 të ligjit nr. 84/2016 është mirëpërcaktuar se me qëllim konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, kërkohet që ai të plotësojë kushtet e kërkuara për të 3 (tri) kriteret duke arritur *nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale*. Ky përcaktim i nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 rregullon specifikisht rastin e konfirmimit në detyrë.

6. Pretendimi i ngritur në lidhje me këtë çështje prej subjektit, se kjo mënyrë e vendimmarrjes së Komisionit pa ia nënshtruar vlerësimit të tri kriterëve sipas ligjit, passjell detyrimisht paragjykim të vendimmarrjes së çështjes, nuk gjendet nga Kolegji si një pretendim i mbështetur në ligj. Vendimi i Komisionit për të mbyllur procedurën administrative, bazuar edhe në pak se tri kriterë, është një vendim që Komisioni e merr si rregull në përfundim të hetimit që ai zhvillon kryesisht në zbatim të neneve 45, 51 e 52 të ligjit nr. 84/2016, por që siç arsyetua më lart mbetet një vendim i revokueshëm në rast se pas zhvillimit të seancës dëgjimore Komisioni arrin në përfundimin se subjekti nuk është në kushtet për t'u shkarkuar nga detyra.

Në këtë fazë Komisioni ka zhvilluar një procedurë të thellë hetimore, nëpërmjet së cilës ka siguruar të dhëna që konsiderohen të mjaftueshme e bindëse për marrjen e një vendimi të mbështetur të paktën në njërin prej kriterëve. Në këto kushte, Komisioni për shkak të parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 do e kishte krejt të panevojshme të thellohej më tej në hetime administrative për komponentët e tjerë, vlerësimi i të cilëve në çfarëdo versionin nuk do të sillte asnjë ndryshim në vendimmarrjen e Komisionit për sa kohë që në bindjen e tij, vlerësimi i një komponenti e çon organin në një vendimmarrje të qartë dhe pa ekuivokë. Përpos këtij arsytimi, parimi i efikasitetit, i parashikuar nga neni 18 i ligjit nr. 44/2015, si një nga parimet mbi të cilat duhet të funksionojë edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i cili është një organ me tipare administrative, e mbështet në aspektin ligjor këtë procedurë të ndjekur nga Komisioni. Përpos këtij arsytimi, vlen të nënvizohet edhe fakti se procesi i rivlerësimit nuk konsiderohet si një gjë e gjykuar për kriteret e pashqyrtuara në eventualitet të një vendimi të Kolegjit që shfuqizon vendimmarrjen e Komisionit, mbështetur vetëm në një ose dy kriterë.

7. Në kuptim edhe të qëllimit të shpallur në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës, e cila parashikon: *Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi*, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit nuk ka për qëllim të verifikojë detyrimisht të tria kriteret e vlerësimit për subjektet e rivlerësimit, si një proces që përcakton standardin e tyre në përmbushje të detyrës apo gradën e vlerësimit të tyre, por kërkon që ky proces të zhvillohet në funksion të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si edhe te garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës.

Në këtë kontekst të qëllimit të Kushtetutës, nuk do të kishte asnjë vlerë dhe qëllim të ligjshëm vazhdimi i procedurës për rivlerësimin e komponentëve të tjerë për sa kohë arrihet në konkluzionin

se edhe në verifikim të një komponenti, subjekti i rivlerësimit duhet të largohet nga sistemi i drejtësisë me qëllim që besimi i publikut të kthehet dhe sistemi të mirëfunksionojë.

8. Referuar në sa parashtruar më sipër, trupi gjykues vendimmarrjen e Komisionit për përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Tom Ndreca, bazuar vetëm në kriterin e kontrollit të pasurisë dhe të figurës, e konsideron një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit, lidhur me situatën faktike dhe ligjin material

9. Në analizë të pretendimit të subjektit se qëndrimi i mbajtur nga Komisioni për deklarimin e rremë lidhur me pagimin e çmimit për blerjen e pasurisë paluajtshme të llojit “garazh” në rrugën “{***}”, Tiranë, është i padrejtë dhe nuk pasqyron të vërtetën, Kolegji konstaton se gjatë hetimit administrativ kanë rezultuar faktet si më poshtë:

- Për pasurinë apartament, me sipërfaqe prej 120 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit, është lidhur fillimisht kontrata e sipërmarrjes më datë 09.01.1997. Kjo kontratë ka si palë investitore Gjykatën e Apelit Tiranë dhe palë ndërtuese shoqërinë “{***}” SH.P.K., për ndërtimin e 18 apartamenteve me vlerë totale 434.000 USD, të ndara në disa kategori: apartament 141 m² me vlerë 28.200 USD; apartament 120 m² me vlerë 24.000 USD dhe apartament 98 m² me vlerë 19.600 USD.
- Në vijim të kësaj kontrate, në datën 07.02.1997, si aneks i kontratës së sipërmarrjes është lidhur mes subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca, përfaqësuesit të kompanisë ndërtuese P.A. dhe përfaqësuesit të investitorit (gjykata e Apelit), z. F.Q, një kontratë individuale që përcakton në detaje mënyrën e pagesës së çmimit për ndërtimin e apartamentit si më poshtë:
 - *Vlera e apartamenti 120 m² është 24.000 USD.*
 - *Kësti i parë prej 720.000 lekësh do të derdhet nga porositësi Tom Ndreca deri më datë 20.01.1997 dhe është 30% e vlerës.*
 - *Kësti i dytë do të paguhet me arritjen e punimeve në katin e 4-t, në sasinë 7.200 USD.*
 - *Kësti i tretë do të paguhet me fillimin e punimeve të rifiniturës në masën 30% të vlerës së përgjithshme, që i përket sasisë 7.200 USD.*
 - *Kësti i katërt dhe i fundit, me vlerë sa 10% e shumës 24.000 USD, e mbetur nga shuma totale e preventuar, do të likuidohet kur të dorëzohet objekti përfundimtar me çelësa në dorë.*

Në këtë aneks kontrate shprehet gjithashtu se për punimet jashtë preventivit, të miratuara nga të dyja palët, pronari i apartamentit duhet t’i bëjë një kërkesë me shkrim shoqërisë ndërtuese “{***}” SH.P.K.

10. Me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 05.04.2003, për apartamentin në rrugën “{***}”, të lidhur ndërmjet përfaqësuesit të shoqërisë sipërmarrëse, përfaqësuesit të Gjykatës së Apelit dhe subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca, është realizuar kalimi i të drejtave të pronësisë së subjektit të rivlerësimit mbi apartamentin e përshkruar më lart. Në pikën 4 të saj,

“Çmimi i kontratës dhe mënyra e pagesës”, parashikohet: [...] *Palët bien dakord që çmimi i shitjes nga ana e shitësit dhe i blerjes nga ana e blerësit të apartamentit objekt shitjeje të jetë 2.400.000 lekë. Kjo shumë është likuiduar plotësisht nga ana e blerësit në favor të kompanisë sipërmarrëse “{***}” SH.P.K., e cila deklaron se e ka marrë këtë shumë para redaktimit të kësaj kontrate dhe jashtë zyrës noteriale.*

11. Për pasurinë “garazh”, me sipërfaqe 18 m², subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën noteriale të shitblerjes me shoqërinë “{***}” SH.P.K., me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 14.04.2003, me vlerë 468000 lekë. Kjo pasuri gjendet në të njëjtën godinë me pasurinë apartament, me sipërfaqe 120 m², të ndodhur në rrugën {***}, Tiranë.
12. Subjekti këto pasuri i ka deklaruar në mënyra të ndryshme në deklaratimet e tij të pasurisë.
 - Pasuria “garazh” në deklaratën e pasurisë *vetting* deklarohet nga subjekti me shpjegimin se edhe pse vlera e garazhit është realizuar me kontratë të veçantë shitblerjeje, kjo pasuri i është ofruar subjektit nga ndërtuesi në ekuivalencë të detyrimeve të krijuara si rezultat i shumë punimeve të kryera privatisht nga vetë subjekti në banesën e tij etj., por që nuk është paguar për blerjen e kësaj pasurie shuma e parave, e përcaktuar në kontratë.
 - Nga verifikimi i deklaratës fillestare të pasurive dhe interesave të bërë nga subjekti në vitin 2003 rezulton se pasuria “garazh” nuk është deklaruar prej tij në rubrikën e pasurive të paluajtshme, megjithëse të drejtat e pronësisë mbi këtë pasuri ishin fituar prej tij në muajin prill të vitit 2003, për pasojë kjo pasuri duhej të ishte deklaruar si e tillë që në deklaratën fillestare të pasurisë. Kjo pasuri gjithashtu edhe në të gjitha deklaratat e tjera periodike të pasurive dhe interesave të bëra nga subjekti pranë ILDKPKI-së nuk është deklaruar. Pasuria “garazh” figuron e deklaruar me shpjegimet e dhëna në paragrafin më sipër vetëm në deklaratën e pasurisë *vetting*, të dorëzuar nga subjekti në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Në lidhje me këtë situatë, subjekti ka pretenduar gjatë fazës së hetimit administrativ se mosdeklarimi i kësaj pasurie në vite ka qenë një harresë e neglizhencë e tij, por pa pasur si qëllim të fshehtë ndonjë pasuri.
 - Në lidhje me pasurinë apartament 120 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën fillestare të interesave periodike të vitit 2003. Deklarimin për këtë pasuri e gjejmë brenda së njëjtës deklarate pasurie në dy faqe të ndryshme të të njëjtit formular A-1, ku deklarohen pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to”, të bërë në mënyra të ndryshme.

Në faqen e parë të formularit A-1, subjekti ka deklaruar se ka blerë apartamentin në vlerën prej 3.000.000 lekësh, me burim të krijimit të kësaj pasurie të ardhurat e fituara nga shitja e apartamentit të privatizuar sipas ligjit dhe të ardhurat familjare.

Në faqen e dytë po të formularit A-1, subjekti ka bërë një deklaram të ndryshëm si në drejtim të vlerës së apartamentit duke e deklaruar se ajo është 2.400.000 lekë, ashtu edhe në drejtim të burimit të krijimit të saj, në të cilin ka përfshirë vlerën e apartamentit të shitur në Rrëshen prej 800.000 lekësh, një hua nga vëllezërit e motrat në vlerën 900.000 lekë, si edhe të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes prej marrëdhënieve të punës për 24 vite.

- Në deklaratën e pasurisë *vetting*, në lidhje me këtë pasuri subjekti ka deklaruar se është fituar për vlerën 2.400.000 lekë dhe si burim të krijimit të kësaj pasurie deklaroi të ardhurat nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, huan nga vëllezërit e motrat në vlerën 800.000 lekë, si edhe të ardhurat e fituara nga shitja e shtëpisë në Rrëshen, në vlerën prej 550.000 lekë.
- Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultojnë edhe dy të dhëna të tjera në funksion të plotësimit të tablosë faktike që përshkruam më lart. Sipas kësaj analize, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka qenë në pamundësi të pasjes së një burimi të ligjshëm financiar në vitin 1999 për pagimin e shumës prej 2.868.000 lekësh për llogari të pagimit të kësteve të apartamentit sipas mandatar-këtimeve të administruara gjatë hetimit administrativ. Gjithashtu, po nga kjo analizë rezulton se, duke pasqyruar të dhënat që rezultojnë nga kontrata e shitblerjes për pasurinë garazh, pra pagimin e shumës prej 468.000 lekësh, subjekti duket se ka qenë në pamundësi të justifikimit të burimit të ligjshëm në vitin 2003, në vlerën prej 110.877 lekësh.

12.1 Duke analizuar të dhënat e pasqyruara më lart, në funksion të shqyrtimit të pretendimit të ngritur prej subjektit të rivlerësimit, se Komisioni ka gabuar kur ka vlerësuar se ai ka bërë deklaram të rremë në lidhje me faktin e pagimit të çmimit për pasurinë garazh sipas asaj që pasqyrohet në kontratën e shitjes së kësaj pasurie, trupi gjykues çmon se qëndrimi i Komisionit është pasojë e arsytimit të saktë e në vlerësim të drejtë të rrethanave dhe se pretendimi i subjektit të rivlerësimit në këtë drejtim nuk qëndron.

Nga të gjitha faktet e prezantuara më sipër e që lidhen me këtë pretendim, trupi gjykues vlerëson se sjellja e subjektit të rivlerësimit në drejtim të deklaramit në mënyrë të saktë e të vërtetë të këtyre pasurive, apartament dhe garazh, nuk është në përputhje me detyrimet ligjore që subjekti i rivlerësimit ka pasur për të bërë ndër vite, në zbatim të legjislacionit që ka rregulluar deklaramin e pasurive dhe konfliktin e interesit të subjekteve të rivlerësimit. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, analiza e këtij pretendimi duhet të bëhet në mënyrë integrale për të dyja pasuritë, për shkak të lidhjes së qëndrueshme që ato kanë me njëra-tjetrën, qoftë në elemente fizike të tyre, por edhe të raportit të ndërsjellë që vetë subjekti i rivlerësimit ka ndërtuar për to, për shkak të deklarimeve që ka bërë.

12.2 Trupi gjykues e sheh të nevojshme të analizojë në funksion të një arsytimi logjik disa elemente faktike, si më poshtë. Së pari, faktin e deklarimeve të ndryshme të pasurisë, të bëra nga subjekti në deklaramin fillestare në lidhje me pasurinë apartament në raport me vlerën e tij (3.000.000 dhe 2.400.000 lekë), të bëra brenda së njëjtës deklarate pasurie, kontradiktoritet që nuk shpjegohet dot me asnjë nga përgjigjet/parashtrimet që subjekti ka dhënë gjatë fazës së hetimit apo edhe në ankim; në raport me përmbajtjen e kontratave të sipërmarrjes për apartamentin dhe aneksin e kësaj kontrate, që përmbajnë të dhëna për vlerën e kësaj pasurie në shumën 24.000 mijë USD, si dhe në harmoni me atë që pasqyrojnë mandatet e arkëtimit, se subjekti ka paguar deri në vitin 1998 në favor të shoqërisë ndërtuese shumën prej 2.868.000 lekësh (duke konsideruar edhe konvertimin e shumës prej 7200 USD me kursin e kohës), si dhe faktin se sipas aneksit të kontratës së sipërmarrjes, duhej të paguhej edhe një kësht tjetër, me vlerë prej 10% të çmimit të dakordësuar, për të cilin nuk ka të dhëna për pagimin e tij.

12.3 Në përfundim të analizës së këtyre elementeve, arrihet në konkluzionin se vlera e paguar prej subjektit të rivlerësimit deri në vitin 1998, e përfaqësuar prej shumës 2.868.000 lekë, është një vlerë e cila ka shërbyer për likuidimin e çmimit të apartamentit, prej 24.000 USD, kjo sipas kontratave të cilat janë nënshkruar nga palët dhe kanë ekzistuar deri në atë moment.

Në vlerësimin e trupit gjykues, pretendimi i subjektit se kjo shifër ka shërbyer edhe për blerjen e mëpasshme të pasurisë garazh, mbetet në nivel deklarativ, pasi nuk gjen mbështetje në asnjë fakt tjetër të provuar gjatë hetimit. Nuk ka asnjë provë që të mbështesë këtë qëndrim të subjektit të rivlerësimit, përveç deklarimeve të tij dhe atyre të dhëna nga ortaku i shoqërisë së ndërtimit në deklaratën e bërë më datë 27.02.2018, vlera provuese e së cilës është e pakonsiderueshme në vlerësimin e trupit gjykues. Për sa kohë që çmohet se për të pasqyruar një marrëdhënie të kësaj natyre palët do të duhej të kishin pasqyruar këtë vullnet në akte shkresore qoftë duke treguar edhe një kujdes minimal, mungesa e akteve shkresore për të provuar këtë marrëdhënie e bën të pamundur mbështetjen e këtij pretendimi nga trupi gjykues.

13. Në këtë kontekst shihet edhe konkluzioni i analizës financiare të kryer në Kolegj, se subjekti ka qenë në pamundësi të justifikojë pagimin e çmimit për këto dy pasuri. Kjo rrethanë hedh dritë edhe mbi diferencën mes vlerës së deklaruar prej subjektit, se është përfituar nga shitja e shtëpisë në Rrëshen, prej 800.000 lekësh, në deklaratën fillestare 2003 dhe vlerës prej 550.000 lekësh të deklaruar si vlerë e përfituar nga shitja e kësaj shtëpie në deklaratën e pasurisë *vetting*, e cila logjikisht duket se është një përpjekje e subjektit për të mbuluar financiarisht shpenzimet për blerjen e pasurisë apartament.

Subjekti përveç se nuk arrin të shpjegojë dhe të provojë me asnjë nga llojet e provave që njeh legjislacioni procedural situatën faktike, nuk arrin dot të japë një shpjegim edhe për disa rrethana të pretenduara prej tij në aspektin logjik. Ai nuk ka asnjë qëndrim apo arsye të deklaruar se përse çmimi i apartamentit të porositur prej 24.000 USD u shndërrua në një vlerë dukshëm më të ulët në kontratën e shitjes prej 2.400.000 lekësh. Ai gjithashtu nuk shpjegon arsyeshëm pse deklaroi dy çmime të ndryshme për pasurinë apartament në deklaratën fillestare të pasurisë, përkatësisht 3.000.000 lekë dhe 2.400.000 lekë, ndërkohë konsideruar kursin e këmbimit të monedhës USD në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, vlera prej 3.000.000 lekësh duket se i korrespondon asaj më së shumti.

Në të njëjtën linjë të paqartësisë konsekuente në raport me deklarin, subjekti i rivlerësimit nuk shpjegon dhe as provon në ndonjë formë, pretendimin e tij për harrimin përgjatë gjithë viteve të deklaramit periodik të pasurisë garazh, megjithëse pronësia mbi të ishte fituar e regjistruar në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme që në vitin 2003.

14. Në konkluzion të kësaj analize, trupi gjykues arrin në përfundimin se vlera e paguar nga subjekti i rivlerësimit, e pasqyruar në mandatarkëtimet të cilat shprehimisht pasqyrojnë faktin se pagesa bëhet për llogari të pagimit të kësteve të apartamentit, në shumën prej 2.868.000 lekësh, ka shërbyer për të shlyer pagimin e çmimit të dakordësuar prej palëve vetëm për apartamentin prej 120 m² në rrugën “{***}”, Tiranë.

Në vijim të këtij konkluzioni, Kolegji arrin në të njëjtin përfundim si edhe Komisioni, se çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes së pasurisë garazh prej 468.000 lekësh përfaqëson çmimin e

blerjes së kësaj pasurie dhe se ai është paguar prej subjektit sipas përcaktimeve që janë bërë në kontratën përkatëse. Nga provat e administruara në hetim, përveç deklarimeve të subjektit, nuk ka rezultuar asnjë fakt i dalë që të vërë në dyshim vërtetësinë e kësaj rrethane që është pasqyruar në këtë kontratë, në ndryshim me sa ka ndodhur për çmimin e pasurisë apartament, të përshkruar më lart.

15. Për të gjitha sa arsyetuar më lart, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të dhëna të rreme në lidhje me faktin e pagimit të çmimit për pasurinë garazh, duke konsumuar elementet e deklarimit të rremë në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.
16. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për qëndrimin e Komisionit, që konsideron si shkaqe për shkarkimin e tij pasaktësitë dhe kontradiktat që kanë rezultuar nga analiza e deklaratave periodike në raport me deklaratën e pasurisë *vetting* apo edhe të deklarimeve në vetë këtë deklaratë, trupi gjykues, duke i analizuar këto pretendime në mënyrë të veçantë, mban qëndrimet si më poshtë.
17. Trupi gjykues vlerëson të nënvizojë që në fillim faktin se Komisioni në përcaktimin që u bën qoftë pasaktësive, qoftë mospërputhjeve të deklarimeve si shkaqe të renditura për shkarkimin e subjektit, nuk i identifikon ato në mënyrë të posaçme dhe as përcakton peshën apo rolin e tyre në drejtim të vendimmarrjes së Komisionit për shkarkim. Analiza e tyre në mënyrë të detajuar do të kryhet nga trupi gjykues në përgjigje të pretendimeve të subjektit në ankim, duke mbajtur në përfundim të analizës edhe një qëndrim për përdorimin e këtyre pasaktësive si shkaqe të mundshme për shkarkimin e subjektit.
- 17.1 Në lidhje me mënyrën e likuidimit të çmimit për pasurinë {***}, apartament me vendndodhje “{***}”, Tiranë, Komisioni ka konkluduar se pagimi i çmimit të kësaj pasurie nëpërmjet pagimit të çmimit me këste, dhe jo nëpërmjet disbursimit të kredisë siç është parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, konsiston në deklarime të pavërteta në raport me çfarë është deklaruar në kontratën e sipërmarrjes. Subjekti ka pretenduar në ankim se mënyra e ndryshme e pagimit të çmimit nuk flet për pasaktësi, por për ndryshim të mënyrës së pagimit të çmimit për shkak të faktit se kredia e pritshme nuk iu dha. Trupi gjykues në përgjigje të këtij pretendimi, e gjen të pambështetur qëndrimin e Komisionit, që një rrethanë të tillë ta konsiderojë si një pasaktësi që mund të përdoret si shkak për shkarkimin e subjektit nga detyra. Mënyrat e pagimit të çmimit të përcaktuar në një kontratë vlejné për të provuar se kjo rrethanë ka ndodhur dhe se palët kanë shlyer detyrimet karshi njëra-tjetrës. Fakti që subjekti nuk ka arritur të përfitojë kredinë që kishte pritshmëri të fitonte në momentin e nënshkrimit të kontratës, nuk bën të pasaktë rrethanën që është përshkruar në kontratë, pasi ngjarja ka ndodhur ndryshe për shkaqe që nuk dihen në momentin e nënshkrimit të kontratës. Për më tepër, kjo rrethanë nuk mund të jetë një element që mund të konsiderohet për efekt të procesit të rivlerësimit, për sa kohë që vetë Komisioni pranon se çmimi i blerjes është shlyer nga subjekti dhe se ai ka pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar fitimin e kësaj pasurie. Për trupin gjykues të Kolegjit, ky fakt i konstatuar prej Komisionit nuk është një pasaktësi në deklarime e subjektit në raport me procesin e deklarimit në vite të pasurisë dhe,

për pasojë, ajo nuk mund të renditet në grupin e pasaktësive që Komisioni ka renditur si shkak për shkarkimin në këtë rast, duke e bërë këtë të dhënë një fakt jorelevant për t'u kualifikuar në këtë formë.

17.2 Subjekti ka pretenduar se arsyetimi i Komisionit se kërkesa për marrjen e kredisë së butë nga subjekti, vjen në kundërshtim me aktet nënligjorë që rregullojnë këtë marrëdhënie juridike dhe kjo sjellje ka cenuar besimin e publikut tek subjekti, është një konkluzion i pasaktë sepse rezulton që subjekti vetëm ka bërë një kërkesë për marrjen e kësaj kredie pa bërë asnjë veprim tjetër. Trupi gjykues edhe në lidhje me këtë pretendim konstaton se Komisioni pavarësisht se e ka përdorur këtë arsyetim, në kuadër të një vlerësimi për këtë rrethanë nuk e ka bashkangjitur atë në mënyrë të posaçme me ndonjë nga shkaqet për shkarkimin nga detyra të subjektit. Pra, Komisioni nuk ka bërë një vlerësim të kësaj rrethane në këndvështrim të ndonjë prej shkaqeve të shkarkimit të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, ndonëse e ka përmendur dhe përdorur si konkluzion të arritur prej tij me konotacion negativ ndaj subjektit. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se në këtë kontekst, ky konkluzion nuk mund të shërbejë si një shkak për shkarkimin e subjektit, sa kohë që vetë Komisioni e ka përdorur këtë arsyetim jo në përfundim të ndonjë analize apo hetimi të mëtejshëm rreth këtij fakti.

17.3 Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka pranuar vlera të ndryshme të së njëjtës shume të marrë hua nga vëllezërit e motrat e tij, duke e dëmtuar atë në këtë mënyrë në analizën financiare dhe se e ka konsideruar pasaktësinë rreth këtij elementi padrejtesisht si element për shkarkimin nga detyra, trupi gjykues çmon se ky pretendim i subjektit qëndron e duhet të reflektohet në vendimmarrjen e tij.

Subjekti ka deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003 një shumë prej 900.000 lekësh, të marrë hua nga vëllezërit e motrat e tij me qëllim blerjen e apartamentit në rrugën “{***}”. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti e ka deklaruar këtë shumë në vlerën 800.000 lekë. Në përgjigje të pyetjes se Komisionit rreth kësaj pasaktësie, subjekti ka deklaruar se shuma e saktë duhet të jetë ajo e deklaruar në deklaratën fillestare, duke qenë se ajo është më afër ndodhjes së faktit. Komisioni pavarësisht këtij shpjegimi, në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, e llogarit këtë shumë në vlerën 800.000 lekë si “të ardhur”, referuar deklaratës së pasurisë *vetting* dhe në vlerën 900.000 lekë si “detyrim”, referuar deklarimeve në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003 dhe deklarimeve në deklaratat periodike të viteve 2004 e 2005 për efekt të shlyerjes së këtij detyrimi.

Në këtë situatë, trupi gjykues vlerëson se kjo mënyrë e llogaritjes në vlera të ndryshme të së njëjtës shumë, është një qëndrim i gabuar i mbajtur prej Komisionit, dhe se vlera e shumës së marrë hua, logjikisht duhet të jetë e njëjtë si kur konsiderohet si “e ardhur”, ashtu edhe kur konsiderohet si “detyrim”. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, kjo shumë në vlerën 900.000 lekë është përfshirë në të dy këta zëra, duke reflektuar për pasojë edhe ndryshimet që kjo e dhënë ka prodhuar në analizën financiare. Në drejtim të faktit se kjo pasaktësi apo mospërputhje e deklarimeve që konstatohet në deklarata, është konsideruar e përfshirë te grupi i pasaktësisë dhe mospërputhjeve të përdorura si shkak për shkarkimin e subjektit, trupi gjykues vlerëson se ajo nuk ka elementet e mjaftueshme për ta konsideruar si të tillë në kuptim të neneve 61 e 33 të ligjit nr. 84/2016.

Vlen të nënvizohet fakti se edhe në lidhje me këtë pasaktësi nuk kemi një qëndrim të qartë e konkret të Komisionit për ta identifikuar atë posaçërisht si një shkak për shkarkim, por nënkuptohet se duhet të jetë përfshirë në grupimin e mospërputhjeve mes deklaramëve të bëra në deklaratë.

17.4 Në lidhje me kundërshtimet që subjekti ka paraqitur për sa i përket grupimit të pasaktësive dhe mospërputhjeve si shkak shkarkimi edhe të faktit se ai ka deklaruar vlera të ndryshme për shitjen e shtëpisë në Rrëshen, trupi gjykues çmon gjithashtu se kjo rrethanë nuk ka elementet e nevojshme për të fituar këtë status në kuptim të neneve 33 e 61 të ligjit nr. 84/2016.

Siç rezulton nga analiza e deklaratës fillestare të pasurisë në vitin 2003, subjekti ka deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament të ardhurat e përfituara prej shitjes së apartamentit të privatizuar në Rrëshen në vlerën prej 800.000 lekësh. Në deklarin që bën për këtë burim në deklaratën *vetting*, subjekti deklaron se vlera e apartamentit të shitur është 550.000 lekë. Në përgjigje të pyetjes së Komisionit në lidhje me këtë mospërputhje, subjekti ka deklaruar se në vlerën prej 800.000 lekësh të deklaruar në deklaratën fillestare, ai ka përfshirë edhe vlerën e shitjes së orendive të banesës, ndërkohë që vlera prej 550.000 lekësh përfaqëson vetëm vlerën e shitjes së apartamentit, të pasqyruar edhe në kontratën e shitblerjes së kësaj prone nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 12.01.1998. Pretendimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit se nga Komisioni në analizën financiare duhej të ishte marrë vlera 800.000 lekë, e deklaruar te deklaratë periodike 2003, trupi gjykues e konsideron si të pambështetur në prova dhe qëndrimin e Komisionit në këtë drejtim të drejtë. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se me të drejtë Komisioni ka përfshirë në analizë financiare si të ardhur vetëm vlerën prej 550.000 lekësh, të provuar me kontratën e shitblerjes.

Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i pasaktë i vlerës së apartamentit në vitin 2003, duke përfshirë edhe një shumë që nuk i përkiste ekzaktesisht kësaj vlere, pavarësisht se ishte e lidhur me të, deklarata që aktualisht është pasuar nga një deklarim i ndryshëm në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke deklaruar saktë vlerën siç e përmban kontrata e shitblerjes, e bën këtë element të pamjaftueshëm për t'u konsideruar si një shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

17.5 Pretendimin e subjektit se mungesa e deklarimit të likuiditetit prej 1.502.097 lekësh në vitin 2016 nuk mund të jetë një pasaktësi që konsiderohet si shkak shkarkimi, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson si pretendim të drejtë. Në analizë të këtij pretendimi, rezulton se Komisioni ka konsideruar se deklarimi i subjektit në deklaratën periodike të viti 2016 nuk ka qenë i saktë sepse ai nuk ka deklaruar shtesën në likuiditet për vlerën 1.502.097 lekë, ndërkohë që në analizë të deklaratës së pasurisë *vetting*, rezulton se subjekti në datën 31.12.2016 e posedonte këtë shumë dhe, si të tillë, duhet ta kishte deklaruar. Në përgjigje të pyetjes së drejtuar subjektit për këtë element, ai është përgjigjur se mosdeklarimi ka qenë një harresë e keqkuptim për shkak të faktit se e kishte deklaruar këtë shumë si gjendje në deklaratën e pasurisë *vetting*, e cila në kohë ka qenë dy muaj para deklaratës periodike të vitit 2016.

Trupi gjykues i Kolegjit, vlerëson se ndonëse nga Komisioni kjo pasaktësi nuk është renditur shprehimisht në grupin e pasaktësisë e mospërputhjeve, fakti që kjo pasuri është deklaruar prej subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe për më tepër sipas vlerësimit të Komisionit, është një pasuri e cila justifikohet ligjërisht prej burimeve të ligjshme të të ardhurave të subjektit, nuk i jep asaj statusin e një pasaktësie e cila mund të përbënte shkak autonom për shkarkimin nga detyra të subjektit sipas neneve 31 e 61 të ligjit nr. 84/2016

17.6 Në lidhje me pretendimin se nuk duhet konsideruar si një pasaktësi që shkakton shkarkimin nga detyra, fakti i mosdeklarimit të llogarive bankare në deklaratat periodike të personave të lidhur, trupi gjykues çmon se ai është i drejtë dhe se ky konkluzion duhet të reflektohet në vendimmarrjen e tij. Nga analiza e deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit dhe e provave të administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka arritur në konkluzionin se personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk kanë deklaruar në disa deklaratat periodike likuiditet që janë gjendur në llogaritë e tyre rrjedhëse të pagës në vlerat si më poshtë:

- a) *Për bashkëshorten K.N., nuk janë deklaruar likuiditet në llogarinë bankare pranë Credins Bank për vitet 2009-2016, për një shumë totale për të gjitha vitet prej 1204255 lekësh.*
- b) *Për djalin E.N., nuk janë deklaruar likuiditet në llogarinë rrjedhëse të pagës pranë Credins Bank për vitet 2014, 2015 dhe 2016, për një shumë totale prej 146.066 lekësh.*
- c) *Për djalin E.N., nuk janë deklaruar likuiditet në llogarinë rrjedhëse të pagës pranë Raiffesisein Bank për vitet 2012-2016, për shumën totale prej 138.800 lekësh.*

Trupi gjykues vlerëson në analizë të kësaj situatë faktike se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur në raport me deklarimin e këtyre likuiditeteve përgjithësisht një qëndrim jo korrekt, për sa kohë që nuk e kanë deklaruar këtë gjendje në deklaratat të ndryshme periodike, por mungesa e këtyre deklarimeve nuk është e shoqëruar me ndonjë sjellje të subjektit për të fshehur të ardhurat dhe, për më tepër, rezulton e provuar nga hetimi administrativ se burimi i krijimit të këtyre pasurive është i ligjshëm dhe vjen nga puna e personave të lidhur. Gjithashtu, gjendja e këtyre pasurive është lehtësisht e verifikueshme dhe e kontrollueshme, për sa kohë që janë llogari brenda sistemit bankar. Mosdeklarimi i tyre në gjithë këto vite duket se ka qenë një qasje e pakujdesshme e subjektit në drejtim të plotësisht me përpikërinë e duhur të deklaratave periodike të pasurisë, por që pavarësisht nuk përmbajnë elemente që do i konsideronin këto pasaktësi të mjaftueshme si shkak autonom shkarkimi në kuptim të neneve 33 e 61 të ligjit nr. 84/2016, por që janë konsideruar nga trupi gjykues në kuptim të vlerësimit tërësor të kriterit të pasurisë.

18. Në konkluzion të analizave të mësipërme për këtë grupim të pasaktësive apo mospërputhjeve, trupi gjykues vlerëson se kategoria e pasaktësive dhe mospërputhjeve të përmendura më lart, të cilat mendohen se janë konkluzionet që përkufizohen si shkaqe shkarkimi të grupuara në pikën *i* e *iv* të shkaqeve të renditura nga Komisioni në drejtim të verifikimit të kriterit të pasurisë, si:

- ✓ *deklarime të pasakta dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 (neni 33, pika 5/a, e ligjit);*

- ✓ *deklarime të pasakta, mosdeklarime dhe mospërputhje deklarimesh, në deklaratat periodike, në kundërshtim me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;*

në rrethanat e analizuara në këtë çështje, këto nuk janë shkaqe që plotësojnë në mënyrë autonome elementet e nevojshme për të fituar statusin e një shkaqe që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33/5 dhe 61/3 të ligjit nr. 84/2016 dhe, si të tilla, nuk duhet të përdoren si konkluzione/shkaqe mbi të cilat mund të mbështet vendimi për shkarkimin e subjektit nga detyra. Lidhur me këtë grupim, trupi gjykues ka vlerësuar se këto pasaktësi duhen konsideruar prej tij në drejtim të vlerësimit tërësor të kriterit të pasurisë.

19. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare të kryer nga Komisioni ka konkluduar se ai ka mungesë të burimeve financiare në shumën prej 1.393.336 lekësh, ka përdorim të të dhënave të pasakta dhe vlerësime të gabuara në lidhje me gjendjen e tij financiare, trupi gjykues pasi konsultoi analizën financiare të kryer në Kolegj, arriti në konkluzionin se vlera e diferencës apo mungesës së burimeve të ligjshme për subjektin e rivlerësimit shkon në shumën 1.978.953 lekë. Në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, trupi gjykues çmoi të pranojë si të provuar për llogari të këtij procesi shumën e evidentuar si diferencë nga Komisioni prej 1.393.336 lekësh, por duke pasur në konsideratë se edhe duke analizuar e shqyrtuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, kjo shumë jo vetëm që nuk zvogëlohej, por rritej drejt shumës së cituar më lart. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, u mor në shqyrtim pretendimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet e kostove të jetesës të kryera prej tij, për të cilat subjekti kishte paraqitur pretendimin se duhej të ishin ato të ILDKPIKI-së në vlerën prej 642.857 lekësh për vitet 2003-2016 (kjo vlerë del nga përpjesëtimi i vlerës totale prej 9.000.000 lekësh të identifikuar në raportin e ILDKPIKI-së si vlera e shpenzuar minimalisht për konsum familjar për 14 vite) dhe jo 944.568 sa ka pranuar Komisioni për subjektin, vlerë të cilën e ka marrë nga INSTAT për shpenzimet mujore për konsum për familje me 4 persona. Trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron, kjo duke konsideruar edhe rrethanat specifike të përbërjes së familjes së tij me 4 persona (me dy fëmijë të rritur që kanë përfunduar studimet universitare), shpenzimet e faturuara për energjinë elektrike, përpjekjen për të rritur cilësinë e jetesës edhe nëpërmjet shtimit të pasurive, si për shembull shtëpia e blerë në bregdet, vlerësohen se janë rrethana që tregojnë se subjekti ka jetuar normalisht duke kapërcyer nivelin e minimumit të shpenzimeve. Trupi gjykues në këtë rast nuk mundet sigurisht të përcaktojë një vlerë të posaçme për shpenzimet e tij jetike, por vlerëson se për këto shpenzime, referuar INSTAT-it, duhet të merren në konsideratë vlera që u përkasin shpenzimeve mesatare mujore për konsum për familje me 4 persona, të cilat janë të njëjta me ato vlera që ka përdorur edhe Komisioni në analizën e tij financiare.
20. Sipas analizës financiare të kryer nga Kolegji, rezulton se përfundimet e arritura nga akti i ekspertimit i paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, në të cilin ai mbështet një pjesë të pretendimeve të tij, që bazohen kryesisht në deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit, sidomos për sa i përket kursimeve të krijuara para viti 2003 në shumën prej 1.405.586 lekë të cilat janë të padeklaruara

nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë, si dhe në shpenzimet e jetesës së subjektit e bën pretendimin e subjektit të pabazuar dhe si të tillë të pakonsiderueshëm nga trupi gjykues.

21. Gjithashtu, në konkluzionet e analizës financiare të kryer në Kolegj, ndryshe nga Komisioni, janë përfshirë të dhënat e llogarive bankare të subjektit dhe të personave të lidhur në çdo fundviti, krahas likuiditeteve të deklaruara si kursime *cash*, si dhe është zbritur një vlerë prej 186.790 lekësh në të ardhurat e tij, për shkak të një përlllogaritjeje gabim të pagës neto të bashkëshortes së subjektit në vitin 2008, e cila sipas vërtetimit nr. 324/1 prot., datë 19.12.2016, të {***} rezulton të jetë 698.119 lekë, ndërsa sipas analizës financiare të Komisionit 884.909 lekë.

Pretendimi i subjektit se duhej të ishte llogaritur më vete shpenzimi për energjinë elektrike, duke e zbritur atë nga kostoja e shpenzimit jetik të familjes, u vlerësua e pambështetur përderisa në llogaritjen që bën INSTAT për përcaktimin e shpenzimeve mesatare mujore për konsum, shpenzimet për pagimin e energjisë elektrike janë domosdoshmërisht të llogaritura e të ponderuara, sepse janë një zë i padiskutueshëm në shpenzimet jetike të çdo familjeje.

22. Në konkluzion të kësaj analize financiare, rezultoi se subjekti nuk arrin të justifikojë shumën prej 1.978.953 lekësh, për periudhën 2004-2009. Duke qenë se Kolegji është vënë në lëvizje dhe po shqyrton ankimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të parimit *no reformatio in peius* përderisa subjekti nuk ka pasur as mundësinë të kontestojë e të mbrohet ndaj këtij rezultati të analizës financiare, u pranua se shuma prej 1.393.336 lekësh, e konkluduar nga Komisioni, do të jetë ajo mbi të cilën Kolegji do të bëjë vlerësimin e tij diskrecionare, nëse gjendemi para situatës së mosjustifikimit “bindshëm” të pasurive të subjektit në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

Në vijim të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vëren se kjo diferencë rezulton si një shumatorë e diferencave që subjekti ka krijuar në vitet 2004- 2009. Pikërisht në vitin 2009 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka fituar pronësinë mbi pasurinë e ndodhur në Golem, e blerë sipas kontratës së shitjes për një vlerë prej 4.400.000 lekësh, duke përdorur si burim të krijimit kursimet nga pagat në vite. Në këtë kontekst, sipas vlerësimit të trupit gjykues, subjekti nuk justifikon bindshëm burimin e ligjshëm për fitimin e kësaj pasurie, të paktën për vlerën prej 1.393.336 lekësh (potencialisht edhe për vlerën prej 1.978.953 lekësh, sipas analizës financiare të përmendur më lart), duke përmbushur në vlerësimin e Kolegjit definicionin e mungesës së justifikimit me burime të ligjshme të pasurisë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e për pasojë të gjendemi para deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin pasurisë sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

23. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se konkluzioni i Komisionit që mosdeklarimi i një automjeti tip Mercedes Benz prej tij, përbën fshehje të pasurisë, mbështetet në të dhëna të pavërteta e është i padrejtë, vlerëson se në analizë të të gjitha rrethanave që shoqërojnë faktin e mosdeklarimit të këtij automjeti prej subjektit, qëndrimi i mbajtur nga Komisioni gjendet i drejtë.
24. Në lidhje me këtë pasuri, nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se personi i lidhur, E. N., ka blerë në vitin 2003 nga shitësi N. O. automjetin tip Mercedes Benz, me targë {***}, me një vlerë prej 250.000 lekësh. Ky transaksion për fitimin e kësaj pasurie është deklaruar në deklaratën fillestare të vitit 2003, duke përshkruar makinë tip Benz e vitit 1987, blerë për një vlerë prej 300.000 lekësh.

Pas këtij deklarami, subjekti apo personi i lidhur nuk kanë kryer më asnjë deklaram tjetër në lidhje me statusin e kësaj pasurie dhe as nuk e kanë deklaruar atë në deklaratën e pasurisë *vetting*. Ndërkohë që nga shkresa me nr. 15477/1 prot., datë 21.12.2017, e sjellë gjatë hetimit administrativ nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRR) është konfirmuar se mjeti figuron ende i regjistruar në këta regjistra në emër të E. N.

25. Në përgjigje të pyetjes së bërë nga Komisioni subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë rrethanë, subjekti ka pretenduar se ai vetë nuk ndodhet në kushtet e fshehjes për automjetin {***}, pasi këtë automjet e ka përdorur gjithmonë djali i tij dhe se në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, nuk e ka disponuar fizikisht atë pasi ai është këmbyer në vitin 2005 me një mjet tjetër me targë {***} (i cili ka ndërruar targë {***}) dhe nuk është poseduar më prej subjektit apo familjes së tij që prej këtij momenti dhe se për këtë shkak ai nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

Gjithashtu rezulton se mjeti i pretenduar si i këmbyer prej subjektit të rivlerësimit, figuron të jetë blerë prej djalit të tij në vitin 2005 nëpërmjet një kontrate shitblerjeje dhe të mos jetë deklaruar në deklaratën periodike të këtij viti. Për këtë automjet figuron vetëm deklarami i shitjes së tij në deklaratën periodike të vitit 2014. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur në Komision deklaratën e bërë nga shtetasi S. D., i cili shprehet se mjeti është shkëmbyer.

26. Në analizë të fakteve që cituam më lart, trupi gjykues çmon se fakti që subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* mjetin me targa {***}, i cili figuron i regjistruar në pronësi të personit të lidhur, duhet parë e konsideruar në raport me deklaramet dhe mosdeklaramet e pasurisë në vite të subjektit në lidhje me këtë pasuri. Fakti i mosdeklaramit në deklaratën e pasurisë *vetting*, është paraprirë nga mungesa e deklaramit të blerjes së automjetit tjetër në vitin 2005, në kundërshtim me detyrimin e subjektit për deklaram sipas ligjit, në një vit në të cilin subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë me diferencë negative në drejtim të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e fituara në atë vit.

Gjithashtu konstatohet se ky automjet deklarohet vetëm në momentin që shitet, në funksion të rritjes së nivelit të të ardhurave për subjektin në vitin 2014, por pa u reflektuar sërish as në këtë moment statusi dhe marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me automjetin e blerë në vitin 2003, i cili pretendohet se ka shërbyer si burim për blerjen apo fitimin e pronësisë mbi automjetin që shitet në këtë vit. Në vijim të kësaj shtate, konstatohet mosdeklarami i pronësisë mbi këtë automjet në deklaratën e pasurisë *vetting*, fakt që në këndvështrim të gjithë përshkrimit të mësipërm e bën vështirësisht të qëndrueshëm e të besueshëm pretendimin e subjekti se ai nuk është deklaruar për faktin se nuk posedohet prej tij e jo në funksion të mbulimit të ndonjë shtate të dyshimtë.

Fakti që automjeti ka mbetur i regjistruar në emër të personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, tregon dhe provon në një nivel të arsyeshëm se pronësia mbi këtë mjet nuk ka ndryshuar për shkak të ndonjë veprimi juridik, përfshirë edhe këmbimin, i cili do të ishte shoqëruar detyrimisht me regjistrimet përkatëse në favor të pronarit të ri të mjetit, për pasojë deklaramet e shpjegimet që bën subjekti në lidhje me këtë fakt konsiderohen se tentojnë të fshehin të vërtetën.

27. Për sa më sipër, rrethanat që shoqërojnë mosdeklaramin e tij, me të drejtë e kanë çuar Komisionin dhe trupin gjykues në konkluzionin se në kundërshtim me detyrimin ligjor që subjekti i rivlerësimit

kishte, ai nuk e ka deklaruar këtë pasuri duke e fshehur atë në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

28. Në lidhje me pretendimin e subjektit se konkluzioni i Komisionit për deklarim të rremë në deklaratën për autorizimin e kontrollit të pasurisë së personave të lidhur, se ata nuk disponojnë pasuri veçmas, nuk duhet konsideruar si shkak shkarkimi. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi rrethanat e faktit, e konstatoi si një pretendim që nuk qëndron në kuptim të detyrimeve që parashikon ligji.

Në lidhje me faktin e pranuar nga Komisioni në vendimin nr. 39, datë 17.07.2018, se personat e lidhur të subjektit të rivlerësimit, bashkëshortja dhe fëmijët, kanë bërë deklarim të rremë në autorizimin për kontroll të deklaratës së interesave, duke deklaruar se nuk disponojnë pasuri veçmas nga subjekti i rivlerësimit - duke mos deklaruar llogaritë e pagave dhe likuiditeteve (sipas nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016) - ky i fundit parashtron disa pretendime dhe komente të tij. Subjekti i rivlerësimit në ankim shprehet se konkluzioni i vendimit lidhur me këtë fakt është i gabuar, pasi ai nuk i ka deklaruar pasuritë që konsiderohen veçmas të djemve dhe të bashkëshortes, pasi ato sipas tij janë pasuri jo të ndara veçmas, por janë familjare dhe, si të tilla, janë deklaruar prej tij.

29. Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në pjesën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, deklarohen përkatësisht të ardhurat nga paga e vetë subjektit gjatë gjithë kohës që ai ka punuar sipas funksionit që ka pasur (për periudhën 1991-2017), të ardhurat e bashkëshortes të fituara nga paga dhe nuk jepet asnjë e dhënë për të ardhurat nga pagat e fëmijëve të subjektit. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, te tabela ku bëhet deklarimi i pasurive dhe likuiditeteve, rezulton se ka deklaruar vetëm llogaritë bankare të llojit depozitë të bashkëshortes dhe njërit prej djemve dhe nuk figuron të ketë deklaruar llogaritë me likuiditetet përkatëse (edhe pse në vlerë të vogël) të pagave të djemve dhe si të dy llogari të bashkëshortes.

30. Në ankim subjekti parashtron se duke deklaruar te deklarata e pasurisë *vetting* edhe llogaritë e llojit depozitë të djalit dhe bashkëshortes, duke dhënë edhe shpjegimet përkatëse, duke shpjeguar se këto llogari kursimesh janë krijuar me burim nga kursimet nga paga, ai pretendon se në këtë mënyrë ka deklaruar të ardhurat nga paga si burimin e krijimit të tyre, i cili është një burim i ligjshëm.

31. Lidhur me këtë arsyetim të subjektit, trupi gjykues sjell në vëmendje faktin se deklarata e pasurisë *vetting* kërkon specifikisht që subjekti i rivlerësimit të deklarojë pagën neto nga fillimi i detyrës deri në momentin e deklarimit si për vete, edhe për personat e lidhur (në këtë rast, djemtë dhe bashkëshortja). Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit, ashtu si edhe Komisioni, konstaton se është fakt i pakontestuar se në deklaratën e pasurisë *vetting* djemtë e subjektit të rivlerësimit, E. dhe E.N., kanë deklaruar se nuk disponojnë pasuri veçmas. Ndërkohë mbetet fakt gjithashtu i provuar se disponimi nga ana e tyre e llogarive të pagave, të cilat rezultojnë të hapura pranë bankave të nivelit të dytë vetëm në emër të tyre, i bën ata të mos kenë pengesa që të disponojnë lirshëm këto llogari (thënë ndryshe të disponojnë veçmas), pasuri të krijuara nga puna e tyre. Ky shpjegim,

lidhur me aksesimin në llogari vetëm nga personat e lidhur dhe nga askush tjetër, bëhet në vijim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, ku në ankim shprehet se bashkëshortja dhe fëmijët janë një familje dhe nuk disponojnë pasuri veçmas.

32. Përveç sa më sipër, nga shqyrtimi i akteve rezulton se djali i subjektit figuron të ketë veçmas të regjistruar edhe automjetin tip Mercedes Benz të shtjelluar më lart, ndërkohë që siç deklaroi vetë subjekti, apartamenti i blerë prej tij në {***} është një pasuri që përdoret prej djalit të tij, E.N.. Në këtë kuptim, rezulton që jo vetëm llogaritë bankare dhe gjendjet në këto llogari disponohen veçmas prej personave të lidhur, por edhe automjeti e të drejtat e përdorimit për apartamentin janë të tilla që disponohen veçmas nga personat e lidhur e, si të tilla, duhej të ishin deklaruar në autorizimin për kontrollin e pasurisë.

Në të njëjtën linjë, edhe personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, rezulton të disponojë veçmas jo vetëm likuiditet që gjenden në llogarinë personale të pagës, por edhe depozitën bankare të deklaruar prej subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*. Detyrimi i personave të lidhur për të qenë të saktë e të vërtetë në deklaratimet që ata bëjnë në deklaratën të pasurisë *vetting*, qoftë edhe për një deklaratim të kësaj natyre nuk është thjesht një kërkesë formale e ligjit, por ajo duhet të shihet si një orientim e shenjë përgjegjësie në drejtim të detyrimeve që kjo kategori subjektësh ka në raport me këtë proces.

33. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, me të drejtë, Komisioni i ka konsideruar këto deklarime të personave të lidhur si të pavërteta e që plotësojnë kushtet për të qenë deklarime të rreme në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

34. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni në hetimin e kryer prej tij nuk mori asnjë provë të re dhe nuk ka dhënë asnjë argument për të shpjeguar pse vendimmarrja e tij lidhur me vlerësimin e pasurisë është negative në ndryshim me atë të bërë nga ILDKPKI-ja, trupi gjykues i Kolegjit çmon se është një pretendim që nuk qëndron, duke përdorur arsyetimin si më poshtë.

35. ILDKPKI-ja është organi kompetent i krijuar mbi një ligj specifik për kontrollin e pasurisë dhe interesave të personave objekt i këtij ligji, trupi gjykues vlerëson se kompetencat e organeve që do të kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke u fokusuar te komponenti i pasurisë, së pari të referojnë te pika 5 e nenit 179/b të Kushtetutës¹ ku përcaktohet:

[...] Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese” [...]. Në vijim, Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, të drejtën për realizimin e procesit të rivlerësimit për subjektet e parashikuara në nenin 179/b të Kushtetutës ia atribuon Komisionit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ndërsa, për sa u përket kompetencave të Komisionit dhe të Kolegjit për një hetim të pavarur dhe të pandikuar nga vlerësimet e organeve të tjera që hartojnë raporte (*siç janë ato që hartohen për kontrollin e pasurisë apo për aftësitë profesionale*), trupi gjykues sjell në vëmendje se këtë çështje

¹ Shtuar me ndryshimet kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, dispozitë e cila përcakton: *[...] Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...].* Kjo dispozitë më tej reflektohet te pika 2.

e ka trajtuar dhe shpjeguar qartë vendimi nr. 2, datë 18.01.2017, i Gjykatës Kushtetuese i cili në paragrafin 4.5 të tij arsyeton: [...] *Ligji në asnjë rast nuk mohon të drejtën dhe kompetencën e organeve të rivlerësimit për të kryer vetë verifikime, çka mund ta bëjnë kryesisht ose nëse krijojnë bindjen se hetimi i ILDKPKI-së nuk ka qenë i plotë dhe i saktë.*

36. Në konkluzion, as Komisioni dhe as Kolegji nuk janë të detyruar të ndjekin apo të kenë qëndrime e konkluzione të njëjta me ILDKPIKI-në në përfundim të këtij procesi, por janë të autorizuar nga Kushtetuta dhe ligji, të bëjnë hetimet e tyre për të kryer një proces rivlerësimi të pavarur e të pandikuar nga konkluzionet e institucioneve ndihmëse.
37. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni për pasurinë nuk ka mundur të provojë se subjekti ka deklaruar pasuri më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, trupi gjykues sqaron se vendimi i Komisionit nr. 39, datë 17.07.2018, masën disiplinore të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë nuk e ka bazuar në përcaktimet e nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon dhënien e masës disiplinore në rastet kur rezulton se subjekti gjatë vlerësimit të pasurisë ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit e konsideron të pabazuar në ligj.
38. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit se ai ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur për kontrollin e figurës në formularin sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues duke analizuar rrethanat e faktit dhe dispozitat ligjore që rregullojnë situatën, çmon se ky pretendim nuk qëndron, ndërkohë që gjendet i drejtë dhe i bazuar konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë kriter.
39. Siç rezulton nga hetimi administrativ, subjekti i rivlerësimit Tom Ndreca nuk ka deklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, faktin që një anëtar i familjes së tij, konkretisht kunati, vëllai i bashkëshortes, N. Gj., ka qenë i proceduar penalisht për veprën penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, sipas nenit 283 të Kodit Penal.
40. Në ankim subjekti i rivlerësimit së pari ngre pretendime që lidhen me mënyrën e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 84/2016 dhe konkretisht pikave 8 dhe 15 të nenit 3 të këtij ligji, duke pretenduar se këto dy pika të nenit 3 zbatohen në mënyrë të pavarur dhe jo kumulative, duke pretenduar se te pika 8 zbatohet lidhja e personit me veprën penale (krimin e organizuar), ndërsa te pika 15 përcaktohet lidhja e pasurisë me veprën penale. Bazuar në këtë arsyetim, subjekti i rivlerësimit në ankim parashtron se kuptimi i tillë i dispozitave ligjore ka qenë një nga shkaqet pse ai në formularin për kontrollin e figurës nuk ka deklaruar kontaktin me N. Gj, kunatin e tij, i cili është proceduar penalisht për veprën penale sipas nenit 283 të Kodit Penal, dhe ndaj të cilit është vendosur më pas pushimi i hetimeve.
41. Lidhur me sa parashtruar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pika 8 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 jep një përkufizim të konceptit “Krim i organizuar, trafikim dhe korrupsion”, duke referuar se cilat janë veprat penale që klasifikohen si të tilla, ndërsa pika 15 e së njëjtës dispozitë jep përkufizimin e individëve të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016, pra në

kuadër të procesit të rivlerësimit, do të konsiderohen si persona të përfshirë në krimin e organizuar. Pra, pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 përcakton rrethin e personave të cilët në kuadër të procesit të rivlerësimit do të konsiderohen si persona të përfshirë në krimin e organizuar, duke referuar si të tillë persona që janë proceduar për veprat sipas pikës 1, neni 3 i ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (në vijim ligji nr. 10192/2009, i ndryshuar).

42. Sipas parashikimit të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se, që një person të konsiderohet “i përfshirë në krimin e organizuar”, në kuptim të këtij ligji, duhet të jetë:

a) Proceduar penalisht për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009. Në kuptim të dispozitave procedurale penale, statusin e personit të proceduar penalisht e merr ai shtetas të cilit i regjistrohet emri në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, në zbatim të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, sipas normave procedurale në këtë moment personi merr cilësinë e personit të dyshuar për kryerjen e një veprave penale dhe ndaj tij zbatohen të gjitha dispozitat që zbatohen edhe për të pandehurin në një procedim penal, sipas nenit 34/4 të Kodit të Procedurës Penale.

b) Së dyti, personi i cili është proceduar për veprën si më lart, nuk duhet të jetë deklaruar i pafajshëm me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Pafajësia e vërtetuar në një proces gjyqësor që ka bërë një vlerësim tërësor të fakteve e rrethanave të çështjes dhe ka konkluduar përfundimisht se personi nuk ka përgjegjësi penale për veprën për të cilën është proceduar, është i vetmi kondicion që ky person të mos bëjë pjesë në këtë grupim.

43. Në analizë të rrethanave të faktit, rezulton se shtetasi N. Gj. është proceduar penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal dhe ndaj tij nuk është marrë një vendim gjyqësor pafajësie i formës së prerë. Për pasojë, ai konsiderohet nga ligji si person i përfshirë në krimin e organizuar për efekt të këtij procesi dhe subjekti kishte për pasojë detyrimin ta deklaronte këtë fakt në deklaratën për kontrollin e figurës në pjesën 5 të saj, te rubrika e të dhënave për sigurinë.

44. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ai nuk e ka deklaruar këtë kontakt sepse nuk ka pasur të njëjtin kuptim për zbatimin e dispozitave të cituara më lart, në vlerësimin e trupit gjykues gjendet i pajustificuar si një pretendim ligjor, pasi mbrojtja për mosnjohje të ligjit nuk i ofrohet asnjë shtetasi në Republikën e Shqipërisë, aq më pak një shtetasi me njohuri të posaçme në fushën përkatëse, siç është gjyqtari i Gjykatës së Lartë.

45. Pretendim tjetër i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me kontrollin e figurës, është se ai çmon se ligji nuk e përfshin kунatin në rrethin e personave të konsideruar anëtarë familjeje. Subjekti shprehet se neni 16 i Kodit të Procedurës Penale ka dhënë përkufizimin se cilët subjekte janë gjini e afërt, janë të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe motrave; krushqi e afërt janë vjehri, vjehrra, dhëndri, nusja, kunati, kunata, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues çmon të nënvizojë faktin se për efekt të zbatimit të ligjit nr. 84/2016 në funksion të procesit të rivlerësimit, vetë shtojca nr. 3 e tij ka marrë përsipër në mënyrë të posaçme të bëjë përcaktimin e rrethit të personave

që do të konsiderohen si anëtarë familjeje. Te ky formular përcaktohet: *Me termin “anëtar familjeje” do të kuptohet bashkëshortja/bashkëshorti i tij, i afërti deri në shkallë të katërt ose krushqia deri në shkallë të dytë, personi i lidhur me detyrime birësimi ose që bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët.* Në këtë kuptim, referimi që bën subjekti te Kodi i Procedurës Penale është i pavend pasi legjislatori ka dashur që, për efekt të procesit të rivlerësimit, të bëjë një rregullim të posaçëm të këtij koncepti të përcaktuar qartazi në ligj. Në vijim të këtij arsyetimi, trupi gjykues çmon se, me të drejtë, Komisioni ka vlerësuar që vëllai i bashkëshortes duhet të konsiderohet person i përfshirë te “krushqia deri në shkallë të dytë” si lidhje dhe duhet të konsiderohet i përfshirë si anëtar familjeje, në kuptim të këtij ligji, për të cilin subjekti kishte detyrimin për deklaram.

46. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni duhej të kishte aplikuar pikën 5/b të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016 si një rrethanë lehtësuese, trupi gjykues nuk e gjen të mbështetur si pretendim për sa kohë që aplikimi i kësaj rrethane është pjesë e vlerësimit që duhet të bëjë Komisioni në rastet kur gjendet para deklaramëve të vërteta e të plota, të bëra nga subjekti, dhe duhet të vlerësojë shkallën e ndikimit apo afërsinë e subjektit me kontaktin e papërshtatshëm. Në rastin konkret, Komisionit nuk i është dashur të kryejë një proces të tillë vlerësimi, pasi ai është gjendur në situatën e mosdeklarimit të kontaktit si një deklaram i pamjaftueshëm në raport me kriterin e kontrollit të figurës dhe jo në situatën e vlerësimit të raporteve të subjektit me kontaktin e papërshtatshëm.
47. Në ankim subjekti i rivlerësimit gjithashtu parashtron se ai nuk ka pasur si qëllim fshehjen e kontakteve të tij me kunatin, pasi ai vetë ka deklaruar lidhjen e një kontrate shitblerjeje automjeti midis bashkëshortes së tij dhe vëllait të saj, kunatit N. GJ., megjithëse automjeti nuk figuron i regjistruar në emër të bashkëshortes, por në emër të kunatit. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se deklarimi i automjetit te deklarata e pasurisë *vetting* është bërë pasi më parë subjekti në deklarimin periodik të vitit 2012 ka deklaruar blerje nga bashkëshortja e tij, me kontratë shitblerjeje të një automjeti, i cili i është shitur nga vëllai i saj, N. GJ., pra logjikisht ka qenë një deklaram i detyruar nga deklarimi i mëparshëm i bërë në vitin 2012, kohë në të cilën as nuk flitej për procesin e rivlerësimit apo për pasoja ligjore të kësaj natyre. Argumenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit si më sipër, nuk konsiderohet nga trupi gjykues i Kolegjit se është i vlefshëm në drejtim të shfajësimit apo mungesës së përgjegjësisë së subjektit për këtë fakt.
48. Lidhur me parashtrimin e subjektit të rivlerësimit për llojin e veprës penale për të cilën është arrestuar e proceduar N. GJ., duke pretenduar se jemi përpara mbajtjes së drogës për përdorim personal dhe jo me qëllim shitjen e saj, e cila në dallim nga përdorimi personal përbën veprë penale, Kolegji arsyeton se bazuar në përcaktimet e nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, në asnjë rast nuk kërkohet që DSIK apo Komisioni të bëjë vlerësim mbi rëndësinë apo peshën e veprës penale. Raporti negativ i DSIK-së, për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca, i vlerësuar si i drejtë nga Komisioni, konsiston në faktin se subjekti i rivlerësimit këtë formular e ka plotësuar me mangësi pasi nuk ka deklaruar lidhjen që ka me një person të përfshirë në krimin e organizuar. Në këtë formular, subjekti për rrjedhojë nuk ka

deklaruar as kontakte të personave të tij të lidhur me këtë person, duke shkëmbyer pasuri ndërmjet tyre (Shtojca 3 e ligjit nr. 84/2016, pika 5, germat “d” dhe “e”).

49. Në referencë të legjislacionit të sipërcituar, trupi gjykues i Kolegjit çmon se lidhja e krushqisë së subjektit të rivlerësimit me vëllain e bashkëshortes konsiderohet krushqi e shkallës së dytë dhe, si e tillë, duhet të ishte deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në formularin e plotësuar prej tij, lidhur me kontrollin e figurës. Mosdeklarimi i kësaj lidhjeje ka shkaktuar pasaktësi në plotësimin e këtij formulari, në kuptim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. Ky fakt, i parë në këndvështrim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84 /2016 dhe të nenit DH, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, konsiderohet se përbën një deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, për sa kohë që subjekti nuk ka provuar të kundërtën e këtij fakti.
50. Në konkluzion të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit dhe qëndrimeve të mbajtura sa më sipër, nga trupi gjykues i Kolegjit arrihet në konkluzionin se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 39, datë 17.07.2018, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.
51. Kolegji vlerëson se në analizë dhe pas një shqyrtimi të bërë prej tij, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, shkaqet e shkarkimit të përmendura në vendimin e Komisionit dhe të pranura si të drejta nga trupi gjykues, duke u parë në raport e të ndërlidhura me njëra-tjetrën krijojnë një tablo të plotë të qasjes së subjektit të rivlerësimit në raport me detyrimet e tij për deklarimin me vërtetësi e saktësi të pasurive të tij dhe personave të lidhur, si edhe në raport me justifikimin e burimeve të ligjshme për këto pasuri.
Në vlerësimin e kësaj situatë që lidhet me të gjitha shkaqet e renditura sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e tij, në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka treguar një qasje jokorrekte e të pasinqertë në raport me deklarimin e tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, por në mënyrë të vazhdueshme edhe në deklaratat e pasurisë në vite, duke e çuar trupin gjykues në përfundimin se ai ka fshehur dhe e ka deklaruar në mënyrë të pasaktë pasurinë në vijimësi, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Për këto arsye, me të drejtë, Komisioni ka konkluduar se ai ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
52. Në të njëjtin arsyetim, trupi gjykues mbështet qëndrimin e Komisionit edhe në drejtim të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit. Mosdeklarimi i një kontakti të papërshtatshëm në formularin për kontrollin e figurës është parashikuar prej nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, si një element që prezumon vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe subjekti i rivlerësimit, megjithëse i gjendur në këto kushte, nuk arriti të provojë në hetim të kundërtën e këtij fakti apo motive a argumente ligjore që e zhvishnin atë nga kjo përgjegjësi. Në këtë kuptim, Kolegji e gjen të drejtë edhe qëndrimin e Komisionit se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
53. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit gjen të drejtë vendimin e Komisionit të marrë në zbatim të nenit D, pikat 3 dhe 5, dhe nenit DH pika 3 të Aneksit Kushtetutës, si dhe nenit 61 pika 3 të ligjit

nr.84/2016 për vendosjen e masës disiplinorë të shkarkimit nga detyra ndaj subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbështetur në faktet e provuara në gjykim dhe në ligjin e zbatueshëm për çështjen,

V E N D O S I:

1. Të lërë në fuqi vendimin nr. 39, datë 17.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Tom Ndreca.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
3. U shpall në Tiranë, më datë 22.11.2018.

ANËTARE
Natasha Mulaj
nënshkrimi

ANËTAR
Sokol Çomo
nënshkrimi

ANËTARE
Rezarta Schuetz
nënshkrimi

RELATORE
Ina Rama
nënshkrimi

KRYESUESE
Albana Shtylla
nënshkrimi